

1. Lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të statistikave të peshkimit në të gjithë vendin për 5 vitet e fundit, të ndara sipas viteve, ju sqarojmë se:

Në bazë të Ligjit Nr. 17, datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, INSTAT është i vetmi autoritet zyrtar përgjegjës për publikim dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore zyrtare në Shqipëri.

Të dhënat janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe mund t’i aksesoni në linkun: <http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/peshkimi/#tab2> . Në këtë link janë publikuar shifrat mbi: zëniet e peshkut sipas kategorive ujore, flotën detare sipas llojit të anijes, flotën detare sipas porteve, zëniet sipas specieve në kategorinë ujërat e brendshme, si dhe zëniet sipas specieve në kategoritë detare, bregdetare dhe laguna.

Të dhënat për vitin 2021 nuk janë publikuar ende. Referuar nenit 34 të Ligjit Nr. 17, datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, kalendari i publikimeve të treguesve statistikorë përditësohet jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit aktual për vitin pasardhës. Sipas linkut <http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/peshkimi/> statistikat e peshkimit për vitin 2021 publikohen në datën 23.6.2022.

2. Lidhur me kërkesën për statistikat e Qarkut të Lezhës për 5 vitet e fundit, të ndara sipas viteve, ju sqarojmë se:

Kjo kërkesë lidhur me të dhënat statistikore për Qarkun e Lezhës nuk është objekt i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Të dhënat e kërkuara nga ana juaj përbëjnë të dhëna të detajuara sipas VKM-së Nr. 256, datë 24.4.2019 “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit”. Për t’u informuar mbi këto të dhëna subjektet e interesuara duhet t’i drejtohen me kërkesë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në pikën 11, Kreu III të VKM-së së mësipërme, në të cilën përcaktohet se:

“Përdoruesit fundorë:

a) përdorin të dhënat vetëm për qëllimet e parashikuara në kërkesën e tyre;

b) citojnë në mënyrë korrekte burimin e të dhënave;

c) janë përgjegjës për përdorimin korrekt të të dhënave lidhur me etikën shkencore sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi;

ç) informojnë drejtorinë lidhur me problemet që mund të kenë të dhënat;

d) u japin drejtorisë përgjegjëse për peshkimin dhe ministrisë rezultatet e nxjerra nga përdorimi i tyre;

dh) nuk u dërgojnë të dhëna palëve të treta pa miratimin e ministrisë;

e) nuk shesin të dhënat te palët e treta.”

Në zbatim të pikës 12, të Kreut III të VKM-së Nr. 256/2019, ju duhet të garantoni me shkrim në momentin e hartimit të kërkesës të gjitha detyrimet e parashikuara në pikën 11, të kreut III, të këtij vendimi, në të kundërt drejtoria përgjegjëse për peshkimin kufizon ose refuzon përdorimin e të dhënave për përdoruesin.

VKM Nr. 256/2019 është përafrim i plotë i Rregullores (EU) 2017/1004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 17 maj 2017 “Për krijimin e një kornize të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) 199/2008 të Këshillit” dhe Vendimit për zbatim të Komisionit (EU) 2016/1251, të datës 12 korrik 199/2016 “Për miratimin e një programi shumëvjeçar të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës për periudhën 2017-2019”.

Gjithashtu, nëse në faqen zyrtare të INSTAT nuk gjeni të dhëna statistikore apo informacionin e dëshiruar, mund t’i drejtoheni me kërkesë INSTAT-it duke plotësuar të dhënat në formularin sipas linkut <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%3%abrko-t%3%ab-dh%3%abna/k%3%abrkes%3%ab-t%3%ab-dh%3%abnash-formulari/>.

3. Lidhur me pyetjen a ka ndikuar ndotja e lagunave në Lezhë në rënien e sasisë së peshkut apo gjallesave të tjera nënujore, ju sqarojmë se:

Zëniet e peshkut në laguna mund t’i gjeni në linkun: <http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/peshkimi/#tab2> në shifrat për zënie peshku sipas kategorive ujore.

Për t’u informuar mbi zëniet e peshkut në lagunat e Qarkut të Lezhës duhet të ndiqni procedurën që ju kemi shpjeguar në pikën 2.

Luhatjet e prodhimit në laguna varen nga shumë faktorë si: ndryshimet klimatike, shfaqja e specieve të tjera jo vendase, callinectes sapidus, e cila po sjell një impakt shumë negativ jo vetëm në lagunat shqiptre, por në gjithë Mesdheun. Kjo specie shumë agresive që për momentin nuk ka konkurrentë dhe predatorë natyrorë, dëmton rrjetat e peshkatarëve edhe peshkun e mbetur në rrjeta. Po kështu, rënie ka edhe ngjala, që është një fenomen mbarëbotëror dhe ashtu sikurse në të gjitha këto vende, popullata e ngjalës është në rënie të shpejtë dhe në Shqipëri gjithashtu. Natyrisht edhe ndotja ka ndikimin e saj, por ky element nuk është faktori kryesor.

Përpara viteve ’90 në lagunat e Lezhës derdheshin ujrata e hidrovorit, i cili merrte edhe ndotjet e fabrikës së letrës në Lezhë, gjë që sot nuk ndodh.